



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KUVENDI**

**PROJEKT LIGJ**

Nr \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2018

**PËR  
DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8691, DATË 16.11.2000  
“PËR PRODHIMIN DHE TREGTIMIN E DUHANIT DHE TË CIGAREVE”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve” të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 3 ndryshohen dhe shtohen përkufizimet si më poshtë:

Në nenin 3, ndryshohen pika 1 dhe pika 2, si më poshtë:

“1. Produkte duhani, nënkupton cigaret, puretat, purot, duhanet për llullë, duhanin kaush, burnotin, duhanin për përtypje, duhanin me ngrohje, duhanin për nargjile dhe gjithë produktet e reja sipas përkufizimeve të këtij ligji.”.

“2. Paketë ose pako, nënkupton çdo kuti ose qese të mbyllur, që përmban produkte duhani.”.

Në nenin 3 shtohem përkufizimet si më poshtë:

“Certifikatë cilesie” nënkupton një dokument zyrtar në formë shkresore, elektronike ose në një mënyrë ekuivalente që vërteton përputhshmërinë e treguesve cilësorët të duhanit dhe produkteve të tij në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

“Cigare” nënkupton mbështjellje duhani e cila mund të konsumohet nëpërmjet procesit të djegies së duhanit, përveç purove dhe cigarilove si dhe mbështjelljet e duhanit.

“Cigare elektronike” nënkupton një produkt që mund të përdoret për konsum të avullit që përmban nikotinë me anë të një pipi, ose çdo përbërës i atij produkti, duke përfshirë një mbajtëse, një depozitë dhe një paisje pa mbajtëse ose depozitë. Cigaret elektronike mund të jenë një përdorimëshe ose me rimbushje me anë të një ene për rimbushje dhe një depozite, ose të rikarikohet me një mbajtëse njëpërdorimëshe.

“Cigarillo” nënkupton duhanin e grirë i mbështjellë me gjethe duhani ose me mbështjellës letre ngjyrë duhani me/ose pa filtër për pirje/tymosje.

“Dengje fshati” nënkupton njësi paketimi të duhanit të papërpunuar, i mbështjellë me çulla, kuti kartoni dhe të lidhura me spango lini.

“Dengje industriale” nënkupton njësi paketimi të gjetheve të duhanit sipas klasave industriale, të fermentuara, paketuar në tonga ose kuti kartoni, sipas llojeve dhe rajoneve.

“Duhani burnot” nënkupton duhanin në formë pluhuri, i trajtuar me lëndë të ndryshme për thithje.

“Duhan i fermentuar” nënkupton gjethe duhani që i nënshtrohet proceseve fiziko-kimike, nën ndikimin e faktoreve të jashtëm si temperatura, lagështia relative e ajrit dhe të brendshëm fermentet e duhanit.

“Duhan kaush për pirje” nënkupton duhanin e grirë në fije të imta që përdoret për pirje pa përpunim të mëtejshëm industrial.

“Duhan për llullë” nënkupton duhanin e grirë trashë, i aromatizuar ose jo, për pirje me llullë.

“Duhan për nargjile”, nënkupton duhanin e aromatizuar i cili konsumohet në formë tymi ose avulli, duke kaluar detyrimisht në një enë uji.

“Duhan me ngrohje” nënkupton një produkt duhani posaçërisht i krijuar për tu ngrohur nëpërmjet një paisjeje që çliron avull me përmbajtje nikotine pa e djegur përzjerjen e duhanit.

“Duhan i papërpunuar” nënkupton gjethe duhani të thara, të shkuara në vargje, që ruhen në kushtet e fermës.

“Duhan i përpunuar” nënkupton gjethe duhani, të ndara në klasa industriale sipas standardeve në fuqi.

“Duhan për përtpje” nënkupton një produkt duhani të prodhuar tërësisht ose pjesërisht nga duhani në formë copash ose pluhuri që konsumohet vetëm me përtpje.

“Enë rimbushëse” nënkupton një paisje që mban një lëng me përmbajtje nikotinë, e cila mund të përdoret për rimbushje të një cigareje elektronike.

“Grumbullues-përpunues duhani” nënkupton një subjekt person fizik ose juridik që ka liçencë për ushtrim të kësaj veprimtarije ekonomike dhe është regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Liçencave.

“Kuti Kartoni” nënkupton njësi ambalazhi për paketimin e duhanit të papërpunuar, të përpunuar, të fermentuar ose të pafermentuar.

“Monitorim” nënkupton kryerjen sistematike të një serie të planifikuar vëzhgimesh ose matjesh me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e ligjit.

“Mostra” nënkupton një sasi përfaqësuese të një partie të caktuar duhani të papërpunuar, të përpunuar dhe/ose produkteve të gatshme, të përcaktuara sipas standardeve në fuqi.

“Produktet e reja të duhanit” nënkuptojnë produktet e duhanit që nuk bëjnë pjesë në asnjë nga produktet e përkufizuara në këtë nen.

“Prodhim i produkteve të duhanit” nënkupton procesin industrial të prodhimit, konfeksionimit dhe ambalazhimit të produkteve të duhanit, që përdoren për pirje/tymosje, nuhatje, përtpje dhe thithje.

“Prodhues duhani” nënkupton një subjekt fermer, person fizik ose juridik, i cili prodhon duhan, dhe është regjistruar në Regjistrin Kombëtar të prodhuesve të duhanit.

“Puro ose puretë” nënkupton një mbështjellje me gjethe duhanit për pirje të punuar vetëm nga duhani natyral, që konsumohet nëpërmjet procesit të djegies.

“Tymi i duhanit” nënkupton tymin e lëshuar nga djegia e produktit të duhanit për pirje, si dhe tymi i nxjerrë gjatë duhanpirjes.

## Neni 2

Kudo në ligj, emërtimet “Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit” dhe “Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve”, do të zëvendësohen përkatësisht me emërtimin “Ministria përgjegjëse për bujqësinë” dhe “Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve”, si dhe fjala “Grumbullues” do të zëvendësohet me fjalët “Grumbullues-Përpunues”.

## Neni 3

Në nenin 9 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si më poshtë:

“1/1. Njësia përgjegjëse e bujqësisë në qarqe pajisin prodhuesin e duhanit me kartelën personale të verifikuar për të gjitha ngastrat kadastrale, mbi bazën e deklaratës së fermerit, vetëm pasi të jetë nënshkruar kontrata me një grumbullues-përpunues të licencuar. Forma dhe përmbajtja e kartelës personale miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë”.

## Neni 4

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 10

1. Grumbullimi i duhanit nga grumbullues-përpunuesit, kryhet sipas standardeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Sezoni i grumbullimit të duhanit të tharë, fillon jo më vonë se data 1 nëntor dhe përfundon më 31 mars të vitit pasardhës. Ndërsa për duhanin jeshil, grumbullimi fillon nga data 1 korrik dhe përfundon më 30 nëntor të vitit.
3. Grumbullues-përpunuesi, para fillimit të këtij sezoni, duhet të demonstrojë në çdo pikë grumbullimi mostrat përfaqësuese për çdo tip/grup duhani, sipas kërkesave të standardeve në fuqi.
4. Grumbullues-përpunuesi, para fillimit të sezonit të grumbullimit, paraqet zyrtarisht në Institucionin përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, dokumentacionin për:
  - a) grafikët e grumbullimit;
  - b) listën e pikave të grumbullimit;
  - c) vendndodhjen e tyre;
  - d) Garanci financiare të lëshuar nga një institucion financiar i licencuar, që garanton shlyrjen 100 % të vlerës së prodhimit të kontraktuar.
5. Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, pas verifikimit të dokumentacionit të sipërcituara, konfirmon zyrtarisht fillimin e sezonit të grumbullimit.

6. Vlerësimi i cilësisë së duhanit kryhet në qendrat e grumbullimit të prodhimit nga grumbullues-përpunuesi dhe prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, bazuar në mostrat përfaqësuese, sipas llojeve dhe klasave si dhe kërkesave të standardeve në fuqi.

Për rivlerësimin e cilësisë së duhanit, ngrihet dhe funksionon komisioni i rivlerësimit të cilësisë me jo më pak se 3 anëtarë, me përbërje të barabartë të palëve, grumbullues-përpunues dhe prodhues, si dhe një përfaqësues nga Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve.

Nëse prodhuesi ka kundërshtime për vlerësimin e cilësisë së prodhimit të tij, grumbullues-përpunuesi mban në ruajtje sasinë e duhanit, për të cilën pajis prodhuesin me dokumentin përkatës. Prodhuesi, brenda 1 (një) dite pune, paraqet me shkrim ose elektronikisht pranë Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve kërkesën për rivlerësim.

Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, brenda ditës, nga momenti i marrjes së kërkesës i'a përcjell atë, Komisionit të Rivlerësimit i cili shqyrton kërkesën dhe merr vendim brenda ditës së kryerjes së rivlerësimit. Vendimi i Komisioni të Rivlerësimit është i detyrueshëm për zbatim nga palët.

7. Kundër vendimit të Komisionit të Rivlerësimit ose kur ai nuk përgjigjet sipas afatit të përcaktuar mund të bëhet ankimim në gjykatën administrative brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e marrjes së njoftimit të vendimit.
8. Përbërja, detyrat dhe funksionimi i Komisionit të Rivlerësimit, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.”.

#### **Neni 5**

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

#### **“Neni 11**

1. Grumbullues-përpunuesit dhe prodhuesit e duhanit rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre duke lidhur kontratë me shkrim, individuale ose kolektive. Një kopje e kontratës dorëzohet nga grumbullues-përpunuesi, në Institucionin përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, brenda 30 ditëve nga lidhja e saj.
2. Brenda një sezoni grumbullimi, një grumbullues-përpunues nuk mund të lidhë kontratë me prodhues duhani, i cili ka lidhur kontratë me një grumbullues-përpunues tjetër për të njëjtën sasi prodhimi.
3. Prodhuesi i duhanit nuk mund të lidhë kontratë me më shumë se një grumbullues-përpunues për të njëjtën sasi prodhimi.
4. Grumbullues-përpunuesi i shlyen detyrimin financiar prodhuesit, jo më vonë se 30 ditë nga dita e lëshimit të faturës për blerjen e duhanit. Në rast se grumbullues-përpunuesi nuk

respekton afatin për pagesën e faturës të nënshkruar nga dy palët, prodhuesi kërkon nga institucioni financiar ekzekutimin e garancisë për shlyerjen e detyrimit.

## **Neni 6**

Në nenin 12, pas fjalës “dengje fshati” shtohet fjala “ose kuti kartoni”, me përjashtim të duhaneve të grupit gjethemëdhenj, të cilat mund të grumbullohen menjëherë pas vjeljes.

## **Neni 7**

Neni 15, ndryshon dhe riformulohet si më poshtë:

1. Prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit regjistrojnë markat e tyre në Regjistrin e Markave të Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve
2. Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, kryen kontrollin dhe analizimin e treguesve fiziko-kimikë të produkteve të duhanit të pranishme në tregun shqiptar një herë në vit. Markat e reja të cigareve para vendosjes në treg, i nënshtrohen vlerësimit shijor Paketat e cigareve me djegie që tregtohen në Shqipëri, në etiketë duhet të përmbajnë të dhëna për sasinë e katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit. Këto të dhëna duhet të maten sipas Standadeve ISO në fuqi. Të dhënat e vlerësimit pasqyrohen në Regjistrin e Markave.
3. Vlerësimi i cilësisë së duhanit dhe produkteve të tij kryhet në laboratorin e Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve.  
Laboratori i vlerësimit cilësor të duhanit dhe produkteve të tij duhet të akreditohet sipas standardit ISO-17025 jo më vonë se dy vjet nga miratimi i këtij ligji.  
Laboratori i akredituar me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë miratohet si laborator reference.  
Deri në marrjen e certifikatës së akreditimit laboratori vazhdon të kryejë shërbimin e parashikuar në këtë ligj.
4. Procedura e regjistrimit të markave të produkteve të duhanit, numri i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Treguesve Shijorë të cigareve, kriteret e emërimit të tij, të drejtat dhe detyrat të këtij komisioni, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 8**

Neni 16 ndryshon dhe formulohet si më poshtë:

1. Duhani tregtohet i përpunuar dhe i manipuluar, në dengje industriale, i fermentuar ose jo, sipas cilësive dhe klasave.

## **Neni 9**

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, është person juridik publik që financohet nga buxheti i shtetit dhe funksionon në varësi të ministrit përgjegjës për bujqësinë.”.

2. Në pikën 4, shkronja b, fjalia e fundit riformulohet:

“Organizimi dhe funksionimi dhe detyrat e Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.”.

## **Neni 10**

Neni 22, ndryshohet si më poshtë:

## **“Neni 22**

### **Kundërvajtjet administrative**

Kur nuk përbëjnë veprë penale shkeljet e mëposhtme të kryera nga persona fizikë e juridikë janë kundërvajtje administrative:

1. Kur prodhuesi i duhanit kultivon dhe prodhon duhan në kundërshtim me pikën 1/1 të nenit 9 të këtij ligji.
2. Kur grumbulluesi-përpunuesi, grumbullon duhan në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji.
3. Kur grumbulluesi-përpunuesi, grumbullon duhan në kundërshtim me kërkesat e pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji.
4. Kur grumbulluesi-përpunuesi, grumbullon duhan në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.
5. Kur grumbulluesi-përpunuesi, grumbullon duhan në kundërshtim me kërkesat e pikës 6 të nenit 10 të këtij ligji.
6. Kur grumbullues-përpunuesi grumbullon duhan në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 11 të këtij ligji.
7. Kur grumbulluesi-përpunuesi, grumbullon duhan në kundërshtim me kërkesat e pikës 2 të nenit 11 të këtij ligji.
8. Kur prodhuesi lidh kontratë me më shumë se një grumbullues-përpunues në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të nenit 11 të këtij ligji.
9. Kur grumbullues-përpunuesi blen duhan në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të këtij ligji.
10. Përpunimi industrial dhe prodhimi i produkteve të duhanit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 14 të këtij ligji.

11. Tregtimi i produkteve të duhanit të pa regjistruar në Regjistrin e Markave të AKDC-së në kundërshtim me pikën 1 të nenit 15.
12. Tregtimi i produkteve të duhanit pa kryer kontrollin e nevojshëm për treguesit fiziko-kimik dhe vlerësimin cilësor në kundërshtim me pikën 2 të nenit 15.
13. Tregtimi i duhanit të përpunuar në kundërshtim me kërkesat e nenit 16, të këtij ligji.”.

### **Neni 11**

Në nenin 22, pika c/1, riformulohet me këtë përmbajtje:

“c/1) Tregtimi i produkteve të duhanit në kundërshtim me kërkesat e neneve 19/b dhe 19/c të këtij ligji në territorin e Republikës së Shqipërisë dënohet me konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve të duhanit.”.

### **Neni 12**

Pas neni 22, shtohet neni 22/1

“ 22/1

1. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 22 nga inspektori i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit jepen këto ndëshkime:
  - a) Për shkeljet e parashikuara në pikën 1/1, gjobë 10 000 (dhjetëmijë) lekë dhe prishjen e sipërfaqes së mbjellë me duhan;
  - b) Për shkeljet e parashikuara në pikën 2, gjobë 1 000 000 (një milion) lekë dhe sekuestrimin e prodhimit të gatshëm, makinerive, pajisjeve dhe materialeve ndihmëse si dhe i propozohet ministrit për heqje të licencës;
  - c) Për shkeljet e parashikuara në pikën 3, gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë
  - d) Për shkeljet e parashikuara në pikën 5, gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë
  - e) Përshkeljet e parashikuara në pikën 6, gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë
  - f) Për shkeljet e parashikuara në pikën 7, gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë
  - g) Për shkeljet e parashikuara në pikën 8, gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë
  - h) Për shkeljet e parashikuara në pikën 9, gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe sekuestrimin e prodhimit të gatshëm.
  - i) Për shkeljet e parashikuara në pikën 10, gjobë 1 000 000 (një milion) lekë si dhe sekuestrimin e prodhimit të gatshëm dhe materialeve ndihmëse.
  - j) Për shkeljet e parashikuara në pikën 11, gjobë 1 000 000 (një milion) lekë si dhe sekuestrimin e produkteve të gatshëm.
  - k) Për shkeljet e parashikuara në pikën 12, gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë si dhe sekuestrimin dhe shkatërrimin e produkteve të duhanit.
  - l) Për shkeljet e parashikuara në pikën 13, gjobë 100 000 (pesëqind mijë) lekë, si dhe sekuestrimin e produktit.



2. Masa e gjobës, në zbatim të këtij neni, është dënim kryesor. Masa e sekuestrimit të makinerive, të pajisjeve, të lëndës së parë, të materialeve ndihmëse dhe të prodhimit të gatshëm, sekuestrimin e produkteve të duhanit dhe heqjes së liçencës përkatëse, të parashikuara në shkronjat “b”, “h”, “i”, “j”, “k”, “l” të këtij neni, janë dënime plotësuese.”.

### **Neni 13**

Neni 17, 18, 19/a, neni 20 dhe neni 21, pika ç, i këtij ligji shfuqizohen.

### **Neni 14**

Neni 25 shtohen pikat paragrafët si më poshtë:

“Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore të parashikuara sipas kërkesave të nenit 15, pika 4.

Ngarkohet ministri përgjegjës për bujqësinë që brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore të parashikuara sipas kërkesave të nenit 9, pika 1/1, nenit 10, pika 8 dhe nenit 15, pika 3.”.

### **Neni 15**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**

**GRAMOZ RUÇI**